NEVOJA E INSTITUCIONEVE PUBLIKE PËR EKSPERTIZA NGA DIASPORA SHQIPTARE

RAPORT I PUNËS KËRKIMORE

germin

ENGAGING DIASPORA PROFESSIONALS

Tiranë, Tetor 2020

Autorët / Hulumtuesit:
Ilir Gadeshi

Rishikuar nga:
Arbnor Mjeku, Amarildo Ceka,
Sihana Bejtullahu, Lirim Krasniqi

Dizajn:
Think B

Publikuar nga: OJQ Germin
Tringë Smajli 48
10000 Prishtinë, Republic of Kosovo
+383 (0) 49 542 525
info@germin.org
www.germin.org

© 2020. germin, të gjitha të drejtat e rezervuara

Mbështetur nga giz Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

Përveç citimeve të shkurtra të bëra për qëllim kritike dhe riprodhimi, asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, transmetohet në çfarëdo forme ose me çfarëdo lloj mënyre, elektronike, përfshirë fotokopjimin, incizimin apo ruajtjen e informacionit e rikthimin e tij me anë të ndonjë sistemi, pa lejen paraprake të autorit.

Shënim:
Opinionet e shprehura në këtë botim janë të Germin, dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet zyrtare të *Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ).*

Përmbajtja

1. Hyrje
2. Emigrimi nga Shqipëria dhe Kosova
3. Diaspora shkencore dhe profesionale
4. Rrugët e bashkëpunimit midis diasporës shqiptare dhe vendeve të origjinës
5. Bashkëpunimi i diasporës shkencore me vendin e origjinës
6. Pengesat
7. Metodologjia
a. Teknikat sasiore
b. Teknikat cilësore
8. **Nevojat e institucioneve**
8.1 Nevojat e universiteteve dhe institucioneve shkencore
8.2 Nevojat e ministrive dhe agjensive shtetërore
8.3 Nevojat e bashkive/komunave
9. Konkluzione dhe rekomandime
Bibliografia
Aneksi 1
Lista e figurave
Figura 1. Vendet me emigracion më të lartë (përqindje e popullsisë)
Figura 2. Vendet kryesore të emigrimit të personave me edukim universitar, 2010–11 (niveli i emigrimit, % e totalit)
Figura 3. . Dinamika e migrimit të trurit nga universitetet/institucionet shkencore 1990-2008 (në %)
Figura 4. Studentët nga vendet e Ballkanit Perëndimor që studjojnë jashtë
Figura 5. Dinamika e PhD shqiptare sipas vitit të përfundimit (në përqindje)
Figura 6. Shpërndarja e diasporës shkencore shqiptare nga Shqipëria dhe Kosova sipas vendeve
Figura 7. Punësimi i PhD shqiptare (në përqindje)
Figura 8. Kushtet për rikthimin e akademikëve dhe kërkuesve
Figura 9. Nevojat për ekspertë të universiteteve/fakulteteve në Shqipëri
Figura 10. Nevojat për ekspertë të universiteteve/fakulteteve në Kosovë
Figura 11. Vlerësimi i nevojave për ekspertë të ministrive në Shqipëri
Figura 12. Vlerësimi i nevojave për ekspertë të ministrive në Kosovë
Figura 13. Vlerësimi i nevojave për ekspertë të bashkive në Shqipëri
Figura 14. Vlerësimi i nevojave për ekspertë të komunave në Kosovë
Lista e tabelave
Tabela 1. Vendi i parë dhe vendi aktual i emigrimit (në përqindje)
Tabela 2. Disiplinat kryesore të studimit

Tabela 3. Bashkëpunimi me universitetet dhe institucionet shkencore
Tabela 4. Dëshira për bashkëpunim me universitetet dhe institucionet shkencoret
Tabela 5. Dëshira për bashkëpunim me universitetet/institucionet shkencore në Kosovë/Shqipëri
Tabela 6. Nevojat për ekspertë të universiteteve/fakulteteve në Shqipëri dhe Kosovë
Tabela 7. Krijimi i kushteve të punës për ekspertët e diasporës shkencore në universitete
Tabela 8. Vlerësimi i nevojave specifike të ministrive dhe agjensive shtetërore në Shqipëri dhe Kosovë
Tabela 9. Mendoni se ekspertët nga diaspora shkencore/profesionale shqiptare do të ishin më të vlefshëm se ekspertët e huaj që vijnë në Shqipëri? (në %)
Tabela 10. Vlerësimi i nevojave specifike të bashkive/komunave në Shqipëri dhe Kosovë
Tabela 11. Mendoni se ekspertët e diasporës shkencore/profesionale do të ishin më të vlefshëm se ekspertët e huaj? (në %)

Hyrje

Shqipëria dhe Kosova kanë krijuar gjatë disa dekadave të emigrimit një diasporë relativisht të madhe shkencore dhe profesionale, të përqëndruar në vendet më të zhvilluara të OCDE, dhe të gatshme të kontribuojë në zhvillimin socio-ekonomik të vendeve të origjinës.[1]Qëllimi i këtij raporti është të tregojë nevojat për ekspertë nga diaspora shkencore dhe profesionale të vendeve të origjinës, format që mund të marrë ky bashkëpunim dhe kushtet që duhen krijuar. Raporti trajton të dy anët e zinxhirit, nga njëra anë, diasporën shkencore e profesionale shqiptare dhe gadishmërinë e saj për të bashkëpunuar, dhe, nga ana tjetër, nevojat e institucioneve shqiptare në Shqipëri dhe Kosovë.

Raporti është organizuar si më poshtë. Në pjesën që vijon flitet për emigrimin shqiptar, nga Shqipëria dhe Kosova, i cili në dekadën e fundit të tij po merr gjithnjë e më shumë tiparet e një brain drain. Në kapitullin e tretë trajtohen format e brain drain që ushqejnë krijimin dhe zgjerimin e një diaspore shkencore dhe profesionale, e cila mund të luajë një rol shumë të rëndësishëm në zhvillimin socio-ekonomik të Shqipërisë dhe Kosovës. Në kapitullin e katërt, të pestë dhe të gjashtë, bazuar kryesisht në studimet e mëparshme të CESS-it trajtojmë disa nga karakteristikat e kësaj diaspore shkencore, rrugët e ndikimit në vendet e origjinës dhe eksperiencën e deri tanishme. Thekse të veçanta vihen mbi pengesat ndaj diasporës shkencore për të kontribuar në dobi të Shqipërisë dhe Kosovës. Ndërsa në kapitullin e shtatë shpjegohet me hollësi metodologjia e ndjekur dhe teknikat e përdorura.Në kapitullin e tetë, bazuar në teknika sasiore dhe cilësore, analizohen nevojat e universiteteve dhe institucioneve shkencore, të ministrive dhe agjensive publike, dhe të bashkive e komunave në Shqipëri dhe Kosovë. Raporti konkludon (Seksioni 9) me një përmbledhje dhe disa rekomandime.

Emigrimi nga Shqipëria dhe Kosova

Shqipëria dhe Kosova kanë përjetuar një periudhë intensive emigrimi gjatë dekadave të fundit. E para duke filluar nga viti 1990, kur vendi hapi kufijtë me rënjen e sistemit socialist. Ndërsa Kosova i njeh këto procese që nga vitet 60' të shekullit të kaluar kur ish-Jugosllavia ndoqi politikën e e hapjes së kufijve dhe i lejoi qytetarët e saj të punonin në vendet e Europës Perëndimore. Pavarsisht nga ndryshimet lidhur me shkaqet, karakteristikat dhe historinë e emigrimit, Shqipëria dhe Kosova karakterizohen aktualisht nga një nivel shumë i lartë i stokut të emigrantëve në raport me popullsinë banuese në vend. Një botim i INSTAT-it vlerësonte se në vitin 2019 rreth 1.64 milionë shqiptarë ose rreth 56 përqind e popullsisë aktuale të Shqipërisë jetonin jashtë vendit, kryesisht në Itali, Greqi, SHBA, Gjermani, Kanada, etj.[2] Ndërsa në Kosovë vlerësohet se mbi 550.000 persona ose më shumë se 30 përqind e popullsisë jetojnë jashtë vendit,[3] kryesisht në Gjermani, Zvicër, Austri, SHBA, Mbretërinë e Bashkuar, Slloveni, etj.[4]

[1] Temaj K., Krasniqi L., (2020) Engaging Albanian Diaspora Professionals. Prishtina: GERMIN; Gëdeshi I., King R., (2019) 'The Albanian scientific diaspora: can the brain drain be reversed?' Migration and Development, DOI:10.1080/21632324.2019.1677072; Gëdeshi I., King R., Research Study on Brain Gain, Reversing Brain Drain with Albanian Scientific Diaspora, UNDP, 2018.
[2]INSTAT., (2019) Diaspora e Shqipërisë në shifra. Tirana: INSTAT.
[3]World Bank (2016) Migration and Remittances Factbook 2016. Washington DC: World Bank.
[4]Temaj K., Krasniqi L., (2020) Engaging Albanian Diaspora Professionals. Prishtina: GERMIN; Uraguchi et al, (2018), Diaspora Communities as a Driving force for Development: Is there a "Business case" HELVETAS.

Këto të dhëna e rendisin Shqipërinë dhe Kosovën në rradhët e para të vendeve të botës, përsa u përket përmasave të migrimit ndërkombëtar (si përqindje ndaj popullsisë aktuale) dhe intensitetit të tij. Banka Botërore në botimet e saj të përvitshme 'Migration and Remittances Factbook', e vendos Shqipërinë dhe Kosovën në 30 vendet e para të botës (Shqipërinë përkatësisht të 17-in dhe Kosovën të 24-ën në botimin e vitit 2016[5]). [6]Ndërkaq, një vështrim i kujdesshëm i kësaj renditjeje tregon se shumica e vendeve që janë përpara Shqipërisë dhe Kosovës, ndryshe nga ato, kanë një popullsi të vogël (nën 1 milion banorë)[7] dhe një histori të gjatë emigrimi (Figura 1).

Figura 1. Vendet me emigracion më të lartë (përqindje e popullsisë)



Burimi: World Bank., Migration and Remittances Factbook 2016, Washington DC, 2016.

Gjatë dekadës së fundit dhe sidomos pas krizës ekonomike globale emigrimi nga Shqipëria dhe Kosova ka marrë disa tipare të reja. Në rast se marrim rastin e Shqipërisë (për të cilën disponojmë më shumë të dhëna) studimet tregojnë se në natyrën e emigrimit shqiptar kanë ndodhur ndryshime të rëndësishme, sasiore dhe cilësore. Faktorët ekonomikë shtytës mbizotërojnë, por ata janë më të zbehtë në krahasim me një dekadë më parë. Pavarsisht se dy vendet fqinje, Italia dhe Greqia, vazhdojnë të jenë vendet kryesore ku është përqëndruar migrimi shqiptar,[8] rëndësia e tyre relative në perspektivë do të vijë duke u zvogluar. Gjermania dhe SHBA janë vendet më të dëshiruara të emigrimit shqiptar, aktualisht dhe në të ardhmen.[9]

[5] World Bank (2016) Migration and Remittances Factbook 2016. Washington DC: World Bank.
[6] Në botimin e fundit të Bankës Botërore (2016) disa nga vendet e Ballkanit Perëndimor, si Bosnia dhe Hercegovina, Kosova, Mali i Zi dhe Maqedonia renditen para Shqipërisë. Por në rastin e këtyre vendeve një pjesë e migrimit ndërkombëtar mund të shihet si migrim i brendshëm brenda ish-Jugosllavisë.
[7] Popullsia e këtyre shteteve luhatet nga rreth 30.000 banorë (Monako) në 800.000 banorë (Guajana). Përjashtim bën West Bank and Gaza që ka një popullsi prej 4 milionë banorësh, por edhe një histori të gjatë migrimi.
[8] IOM., (2020) National Household Migration Survey in Albania. Tirana: IOM.
[9] King R., Gëdeshi I., 'New trends in potential migration from Albania: the migration transition postponed', Migration and Development, 9(2), pp. 131–151, 2020; Gëdeshi I., King, R. (2018) New Trends in Potential Migration from Albania. Tirana: F. Ebert Foundation.

Këto ndryshime në faktorët shtytës dhe gjeografinë e emigrimit shqiptar pasqyrohen edhe në strukturën socio-demografike dhe cilësinë e flukseve të tij. Dëshirojnë të migrojnë më shumë të rinjtë në fund të 20-ve, më të arsimuarit dhe të kualifikuarit, të punësuarit dhe ata me të ardhura të mesme e të larta.[10] Rrjedhimisht emigrimi nga Shqipëria po merr gjithnjë e më shumë tiparet e brain drain-it, çka do të ketë pasoja negative për të ardhmen e vendit. Edhe Banka Botërore, siç shihet në Figurën 2, në botimin e saj 'Migration and Remittances Factbook 2016' e rendit Shqipërinë në 20 vendet e para të botës (përkatësisht të 15 në botimin e 2016) lidhur me përqindjen e personave me edukim terciar që kanë emigruar nga vendi.[11]

Figura 2. Vendet kryesore të emigrimit të personave me edukim universitar, 2010–11 (niveli i emigrimit, % e totalit)



Burimi: World Bank., Migration and Remittances Factbook 2016, Washington DC, 2016.

Emigrimi i trurit

Në rrjedhën e emigrimit të trurit shqiptar ne mund të dallojmë tre grupe të mëdha, të cilat kanë ndikuar në krijimin dhe rritjen e diasporës shkencore dhe profesionale shqiptare. Grupi i parë përbëhet nga inxhinierët, agronomët, mësuesit, gjeologët, ekonomistët, mjekët, artistët, etj që filluan të emigrojnë që në vitet e para të tranzicionit pas-socialist, të shtyrë kryesisht nga faktorë ekonomikë - papunësia, varfëria dhe ashpërsia e reformave të tranzicionit - ose nga pasiguria që krijuan ngjarjet pas shëmbjes së firmave të korruptuara piramidale në 1997[12]. Kjo formë e emigrimit të trurit është rigjallëruar sot, ku grupe të caktuara profesionistësh, si inxhinierë, informaticienë, mjekë, infermierë, etj, përgjithësisht të rinj, largohen nga vendi kryesisht në drejtim të Gjermanisë.

[10] King R., Gëdeshi I., 'New trends in potential migration from Albania: the migration transition postponed', Migration and Development, 9(2), pp. 131–151, 2020; Gëdeshi I., King, R. (2018) New Trends in Potential Migration from Albania. Tirana: F. Ebert Foundation.
[11] World Bank (2016) Migration and Remittances Factbook 2016. Washington DC: World Bank.
[12] Gëdeshi I., Mara H., Dhimitri R., Krisafi H. (1999) Emigrimi i Elites Intelektuale nga Shqipëria gjatë Periudhës së Tranzicionit. Tirana: Shtëpia Botuese "Luarasi"; Gëdeshi I., Germenji E. (2008) Highly Skilled Migration from Albania: An Assessment of Current Trends and the Ways Ahead. Brighton: DRC Migration, Globalisation and Development, Working Paper T25.

Figura 3. Dinamika e migrimit të trurit nga universitetet/institucionet shkencore 1990-2008 (në %)



Burimi: CESS, 2008

Grupi i dytë përbëhet nga pedagogët, kërkuesit dhe profesionistë të tjerë, shumica e tyre të rinj (mosha mesatare rreth 35 vjeç) dhe të arsimuar ose specializuar (43 përqind e tyre) në vendet e BE dhe ShBA, të cilët emigruan familjarisht dhe në rrugë legale.[13] Ky emigrim, siç e tregon edhe Figura 3, kulmoi dy herë (1991-1993 dhe 1997-1999)[14] në dekadën e parë të tranzicionit dhe thuajse shuhet në dekadën e dytë të tij. Sidoqoftë, për periudhën 1990 - 2008 vlerësohej se rreth 40.6 përqind e stafeve universitare dhe e institucioneve shkencore kishin emigruar nga vendi,[15] shifër kjo shumë më e lartë se e vendeve të tjera në tranzicion.[16] Emigrimi i elitave universitare shkaktoi jo vetëm humbjen e kapitalit human, por edhe dobsimin e kapaciteteve humane për të përgatitur gjeneratat e reja në Shqipëri.[17]

Figura 4. Studentët nga vendet e Ballkanit Perëndimor që studjojnë jashtë



Burimi: UNESCO, 2017.

[13] World Bank (2010) Albania, the New Growth Agenda: A Country Economic Memorandum. Washington DC: World Bank Report No. 53599-AL.
[14] Kulmimi i 1991-1993 reflekton hapjen e menjëhershme të vendit pas një periudhe vet-izolimi 45 vjeçar, ashtu si dhe krizën ekonomike, politike dhe sociale që u shfaq në vitet e para të tranzicionit pas-socialist. Ndërsa kulmimi në 1997-99 mund të shpjegohet me kaosin ekonomik, politik e social që përjetoi Shqipëria pas shëmbjes së firmave piramidale.
[15] Gëdeshi I. (2008) The relationship between migration and socio-economic changes in Albania, Der Donauraum, 48(3): 197–292; World Bank (2010) Albania, the New Growth Agenda: A Country Economic Memorandum. Washington DC: World Bank Report No. 53599-AL.
[16] Horvat V. (2004) Brain drain threat to successful transition in South East Europe? South-East European Politics, 5(1): 76–93.
[17] World Bank (2010) Albania, the New Growth Agenda: A Country Economic Memorandum. Washington DC: World Bank Report No. 53599-AL.

Ndërsa grupi i tretë përbëhet nga studentët shqiptarë që arsimohen jashtë vendit dhe pas përfundimit të studimeve qëndrojnë në vendin pritës ose emigrojnë në një vend tjetër. Në rast se i referohemi statistikave të UNESCO-s numri i studentëve shqiptarë në universitetet e vendeve të zhvilluara të OECD-së ka qënë për një periudhë të gjatë në rritje. Në rast se në vitin 1998 studjonin jashtë vendit 4,711 studentë shqiptarë, në vitin 2011 kjo shifër arriti në 25,309 studentë, për tu ulur pastaj në 17,448 studentë në vitin 2017 .[18] Këto shifra e vendosin Shqipërinë në krye të vendeve të Ballkanit Perëndimor (Figura 4), pavarësisht se nga popullsia ajo renditet e katërta dhe nga të ardhurat për frymë e parafundit në rajon.[19]

Diaspora shkencore dhe profesionale

Diaspora shkencore dhe profesionale shqiptare është krijuar dhe rritet nga këto tre rrjedha të emigrimit të trurit, ashtu si dhe nga fëmijët e emigrantëve shqiptarë të cilët studjojnë në vendet pritëse. Ekzistojnë koncepte të ndryshme për diasporën shkencore. Në konceptin tonë, nocioni i diasporës shkencore është më i gjerë se sa fenomeni i emigrimit të trurit. Emigrimi i trurit është
një proces ku shkencëtarët dhe profesionistë të tjerë të kualifikuar emigrojnë në vende të tjera, të cilat përjetojnë një "brain gain", pavarësisht se ata mund të mos punësohen në përputhje me kapitalin e tyre human, sidomos kur ka pengesa gjuhësore,
probleme me njohjen e diplomave dhe kualifikimeve profesionale ose praktika diskriminuese në tregun e punës (rezultati në këtë rast është një humbje e trurit). Një diasporë shkencore dhe profesionale përfaqëson një "shpërndarje" afatgjatë të talenteve shkencore dhe profesionale të vendit, duke përfshirë këtu edhe ato të cilët janë formuar jashtë vendit nëpërmjet studimit dhe trajnimit të mëtejshëm – të tilla si marrja e një PhD.

Në këtë studim ne kemi përfshirë vetëm një segment të diasporës shkencore dhe profesionale shqiptare: ata që zotërojnë ose janë duke përgatitur një PhD në universitetet e vendeve të BE, ShBA, Kanada, etj. dhe jetojnë e punojnë në këto vënde ose janë zhvendosur në vënde të tjera, por nuk janë kthyer në Shqipëri ose në Kosovë. Ky është segmenti më cilësor dhe dinamik i diasporës shkencore shqiptare, produkt i viteve të gjata të studimit e kërkimit shkencor, lehtësisht i identifikueshëm e i matshëm, dhe që përbën një faktor shumë të rëndësishën për kërkimin dhe inovacionin. Ky segment mund të luajë një rol shumë të rëndësishëm në shpërndarjen e dijeve nëpërmjet kontakteve face to face, edukimin e studentëve, trainimin e kërkuesve të rinj dhe në dinamizimin e universiteteve dhe institucioneve shkencore në Shqipëri dhe në Kosovë.[20] Përzgjedhja e këtij segmenti ka edhe një arësye praktike: ai mund të influencojë më shumë në opinionin publik dhe në politikbërësit shqiptarë lidhur me rolin e diasporës shkencore për shkak të rëndësisë dhe përmasave që ai ka.

[18]UIS.Stat.
[19]King R., Gëdeshi I., (2020) The actual and potential migration of students from Albania: a putative brain drain? (forthcoming), F. Ebert Foundation.
[20] Moguérou P. (2006) The Brain Drain of PhDs from Europe to the United States: What We Would Like to Know. Florence: European University Institute, RSCAS Working Paper 2006/11.

Një nga karakteristikat e diasporës shkencore shqiptare është se ajo rritet me ritme shumë të shpejta (Figura 5). Në rast se do të analizojmë periudhën 1988 – 2017, duke e ndarë në përafërsisht 3 dekada, do të vërejmë se numri i PhD shqiptare (duke u nisur nga viti i përfundimit) rritet me një ritëm shumë të shpejtë. Ai është 2.6 herë më i lartë në dekadën e dytë në krahasim me të parën dhe 3.3 herë më i lartë në dekadën e tretë në krahasim me të dytën. Kjo tendencë rritjeje e shpejtë do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Kështu nëqoftëse analizojmë studentët PhD sipas vitit të fillimit do të vërejmë se numri i tyre gjatë periudhës 2012 – 2016 ka qënë në rritje dhe thuajse 154 përqind më i lartë se gjatë periudhës 2007-2011.

Figura 5. Dinamika e PhD shqiptare sipas vitit të përfundimit (në përqindje)



Burimi: CESS, Albanian Scientific Diaspora, 2017.

Janë disa faktorë që e ushqejnë këtë rritje. E para ndër to' është se numri i emigrantëve shqiptarë në vendet e OCDE-së është në rritje dhe një nga objektivat e emigrimit është arsimimi i mirë i fëmijëve. Fëmijët e tyre ndjekin shkollat dhe universitetet në vendin pritës dhe një përqindje në rritje vazhdojnë studimet për PhD. Së dyti, edhe numri i studentëve shqiptarë që studjojnë në vendet e OCDE-së është në rritje dhe një pjesë e tyre vazhdojnë më pas studimet për PhD. Në kampionin tonë 68 përqind e PhD ose kandidatëve për PhD kanë kryer edhe studimet universitare jashtë vendit. Pavarësisht se është shpërndarë në të gjitha kontinentet dhe në rreth 40 vende të botës, thuajse 72 përqind e diasporës shkencore nga Shqipëria është përqëndruar në vendet më të industrializuara të OCDE, si në ShBA, Itali, Francë, Kanada, Angli dhe Gjermani (Figura 6). ShBA udhëheqin me 28.3 përqind dhe janë vendi i parë ku është përqëndruar diaspora shkencore shqiptare dhe, siç do të shohim, është destinacioni kryesor i PhD shqiptare në rrugëtimin e gjatë të tyre. Kështu të dhënat e anketës tregojnë se 18 përqind e PhD shqiptare që aktualisht jetojnë në ShBA i kanë kryer studimet për PhD kryesisht në Itali, Francë, MB, Gjermani dhe Hollandë.

Figura 6. Shpërndarja e diasporës shkencore shqiptare nga Shqipëria dhe Kosova sipas vendeve



Burimi: CESS, Albanian Scientific Diaspora, 2017.

Ndërsa Italia me 15.3 përqind zë vendn e dytë dhe përngjet më shumë me pikën e nisjes. Afërsia gjeografike dhe kulturore, numuri i madh i emigrantëve shqiptarë, politikat favorizuese ndaj studentëve janë disa nga faktorët kryesorë që shpjegojnë përqëndrimin e madh të diasporës shkencore shqiptare në këtë vend. Vendet e tjera (Francë, Kanada, Angli dhe Gjermani) janë pak a shumë në nivel të njëjtë, por pozitat e tyre kanë ndryshuar gjatë kohës. Kështu vendi i Francës, e cila zinte vëndin e parë deri në vitet e para të tranzicionit, është ulur.[21] Ndërsa nga ana tjetër është rritur vendi i MB dhe vitet e fundit ai i Gjermanisë.

Një pjesë tjetër e diasporës shkencore shqiptare (rreth 18 përqind) është përqëndruar në disa vënde të vogla (në termat e popullsisë), por shumë të zhvilluara të Europës Perëndimore, si në Hollandë, Zvicër, Norvegji, Suedi, Austri, Belgjikë dhe Danimarkë. Në këto vende, ku ka një cilësi të lartë jetese, ata janë punësuar në universitete dhe institucione shkencore të shquara ose në firma shumëkombëshe të dëgjuara. Të tjerë janë shpërndarë edhe në vendet e largëta, si në Australi (1 përqind) dhe Japoni (0.8 përqind).

Në dallim me diasporën shkencore nga Shqipëria, thuajse gjysma e asaj nga Kosova dhe Maqedonia është përqëndruar kryesisht në vendet tradicionale të emigrimit të tyre, si në Gjermani, Zvicër, Austri, Angli dhe vendet Skandinave. Megjithatë, edhe në rastin e diasporës shqiptare nga Kosova, vendin e parë e zenë ShBA (15 përqind).

[21] Deri në fund të viteve 1980', shumica e studentëve shqiptarë jashtë vendit studjonin në Francë (72 përqind), dhe më pak në Itali (13 përqind), Austri (9 përqind), dhe Greqi (3 përqind).

Tabela 1. Vendi i parë dhe vendi aktual i emigrimit (në përqindje)

Nr	Vendet	Vendi i parë i emigrimit	Vendi aktual pritës	Diferenca
1	Itali	26.2	15.3	-10.9
2	ShBA	18.2	28.3	**+10.1**
3	Greqi	9.0	1.1	-7.9
4	Francë	6.6	7.4	**+0.8**
5	Turqi	5.4	2.1	-3.3
6	Gjermani	5.2	6.2	**+1**
7	MB	4.8	7.2	**+2.4**
8	Kanada	3.2	7.4	**+4.2**
9	Hollandë	3.1	4.4	**+1.3**
10	Austri	2.1	1.8	-0.3
11	Bullgari	1.8	0	-1.8
12	Zvicër	1.7	3.1	**+1.4**
13	Belgjikë	1	1.7	0.7
14	Norvegji	1	2.1	**+1.1**
15	Suedi	0.8	1.9	+0.8

Burimi: CESS, Albanian Scientific Diaspora, 2017.

Diaspora shkencore shqiptare karakterizohet nga një mobilitet i lartë. Në rast se shikojmë vendin e parë të emigrimit dhe atë aktual do të shohim se kjo diasporë ka lëvizur nga njëri vend në tjetrin duke pasur si pikë fundore MB, Gjermaninë, Francën, Hollandën, Zvicrën dhe vendet Skandinave në Europë ose ShBA dhe Kanadanë përtej Atlantikut. Kjo duket qartë në tabelën e mësipërme ku vende si Greqia, Italia, Turqia, Bullgaria dhe më pak Austria janë vendi i parë i emigrimit dhe kanë shërbyer si pikënisje për të vazhduar rrugëtimin në vende më të zhvilluara si ShBA, Kanada, MB, Gjermani, Francë, etj (Tabela 1). Kështu në trajektoren nga 'vendi i parë i emigrimit' në 'vendin aktual pritës' Italia dhe Greqia kanë humbur 10.9 dhe 7.9 pikë, ndërsa ShBA dhe Kanadaja kanë përfituar 10.1 dhe 4.2 pikë.

Tabela 2. Disiplinat kryesore të studimit

Nr	Disiplinat kryesore të studimit	Përqindje
1	Ekonomi dhe biznes	17
2	Shkenca të tjera sociale (Shkenca politike, Sociologji)	19
3	Juridik	4
4	Kompjuter/informatikë/elektronikë	10
5	Inxhinieri dhe ndërtim	13
6	Mjeksi dhe të përafërta	14
7	Shkenca të tjera (Biologji, Matematikë, Fizikë)	18
8	Tjetër (duke përfshirë Arkitekturë, Gjuhë, Media etj.)	5
	Total	100

Burimi: CESS, Albanian Scientific Diaspora, 2017.

Diaspora shkencore shqiptare është e diversifikuar nga pikpamja e disiplinave të studimit. Këtë gjë tregon tabela e mësipërme ku disiplinat kryesore të studimit të PhD shqiptare të anketuar u ndanë në disa grupe të mëdha (Tabela 2). Të dhënat e anketës tregojnë se rreth 19 përqind e tyre janë në shkencat sociale, 18 përqind në 'biologji, matematikë, fizikë', 17 përqind në 'ekonomi dhe biznes', 14 përqind në 'mjeksi dhe disiplina të përafërta', 13 përqind në 'inxhinieri dhe ndërtim', dhe 10 përqind në 'kompjuter/informatikë/elektronikë'.

Figura 7. Punësimi i PhD shqiptare (në përqindje)



Burimi: CESS, Albanian Scientific Diaspora, 2017.

Kjo diasporë shkencore është e punësuar kryesisht në universitetet, laboratorët dhe institucionet shkencore të vendeve të zhvilluara (Figura 7). Të dhënat e anketës tregojnë se 62 përqind e PhD shqiptare janë punësuar në universitete dhe institucione shkencore, 23 përqind në firma private dhe 8 përqind në institucione publike. Përqindja e PhD shqiptare të punësuara në universitete/institucione shkencore është më e lartë në MB, ShBA, Gjermani, dhe Hollandë.

Rrugët e bashkëpunimit mes diasporës shqiptare dhe vendeve të origjinës

Diaspora shkencore dhe profesionale shqiptare mund të ndikojë në zhvillimin socio-ekonomik të Shqipërisë dhe Kosovës nëpërmjet dy rrugëve kryesore. E para është rikthimi i përfaqsuesve të diasporës shqiptare në vendlindje. Ky rikthim i emigrantëve shumë të kualifikuar, të përgatitur gjatë viteve në universitetet, laboratoret dhe institucionet shkencore të vendeve më të zhvilluara të OCDE-së, do të sillte aftësi të reja, eksperiencë dhe dije, të afta të dinamizonin jetën akademike dhe shkencore në Shqipëri dhe Kosovë. Ndërkaq, studimet tregojnë se rikthimi i migrantëve shumë të kualifikuar lidhet në përgjithësi me zhvillimin ekonomik e social të vendit të origjinës, ashtu si dhe me zhvillimin e universiteteve dhe të kërkimit shkencor. Një anketë e realizuar nga CESS-i me përfaqsues të diasporës shkencore në Shqipëri tregoi kushtet që duhen plotësuar për rikthimin e qëndrueshëm të tyre.

Përgjigjet e përfaqsuesve të diasporës shkencore ne i ndamë sipas karakteristikave në tre grupe (Figura 8). Grupi i parë i kushteve lidhet me një 'stabilitet më të madh ekonomik dhe politik' (66 përqind), 'zvoglim të nivelit të korrupsionit' në vend (64 përqind), 'rritje të sigurisë së punës dhe siguri sociale' (52 përqind), 'përmirësim të rendit publik' (37.5 përqind), 'përmirësim të infrastrukturës dhe mjedis i pastër' (32 përqind), dhe një 'jetë më të pasur sociale dhe kulturore' (23 përqind).

Figura 8. Kushtet për rikthimin e akademikëve dhe kërkuesve



Burimi: CESS, Albanian Scientific Diaspora, 2017.

Grupi i dytë lidhet me zhvillimin e arsimit dhe të shkencës në Shqipëri. Diaspora shkencore dhe profesionale kërkon një 'reformim të thellë në universitete dhe në kërkimin shkencor' (52 përqind), ashtu si dhe 'rritjen e investimeve në edukim dhe shkencë' (49 përqind) dhe një 'ndryshim të mentalitetit' (29.5 përqind) në vend. Të anketuarit dëshirojnë që këto institucione të drejtohen nga individë të zgjedhur mbi bazën e meritave, të cilët e vlerësojnë dhe motivojnë kërkimin shkencor dhe mësimdhënjen.

Ndërsa grupi i tretë lidhet me të ardhurat personale financiare, ku ata theksojnë një 'pagë të njëjtë' me atë që marrin në vendin pritës (36.6 përqind) ose një 'pagë konkurruese' (13.8 përqind). Është interesante se pagat, megjithëse të rëndësishme për mirëqënien e çdo individi, nuk përbëjnë elementin kryesor të rikthimit të tyre.

Për këdo është e qartë se këto kushte socio-ekonomike dhe infrastruktura e duhur kërkimore nuk mund të krijohen në afat të shkurtër dhe të mesëm në Shqipëri. Rrjedhimisht edhe opsioni i rikthimit të qëndrueshëm të përfaqësuesve të diasporës shkencore nuk do të ishte një politikë realiste, e qëndrueshme dhe afat-gjatë. Ajo do të prodhonte zhgënjim dhe një riemigrim të tyre.

Rrjedhimisht rruga më realiste për ndikimin e diasporës shkencore në zhvillimin e Shqipërisë dhe Kosovës do të ishte bashkëpunimi i saj me universitetet, institucionet shkencore, bizneset dhe institucionet qendrore dhe lokale publike.

Bashkëpunimi i diasporës shkencore me vendin e origjinës

Deri tani vetëm 22 përqind e PhD shqiptare të anketuar me origjinë nga Shqipëria dhe 31 përqind nga Kosova thonë se kanë bashkëpunuar me universitetet dhe institucionet shkencore në vendlindje (Tabela 3). Në rast se marrim si shembull rastin e Shqipërisë ky tregues është i ulët po të kemi parasysh se 26.5 përqind e përfaqsuesve të diasporës shkencore kanë punuar para se të emigronin dhe kanë qenë pjesë e stafeve në universitetet dhe institucionet shkencore të vendit. Një pjesë tjetër ose 11 përqind kanë qënë studentë dhe janë arsimuar në universitetet shqiptare. Të tjerë kanë bashkëpunuar në marrjen e informacionit gjatë përgatitjes së PhD, në konferencat shkencore dhe botimin e artikujve.

Tabela 3. Bashkëpunimi me universitetet dhe institucionet shkencore

Nr	Bashkëpunimi	Shqipëri	Kosovë
1	Po, kam bashkëpunuar	21.9	31.2
2	Jo, nuk kam bashkëpunuar	73.2	63.6
3	Pa përgjigje	4.8	5.2
	Total	100	100

Burimi: CESS, anketa me diasporën shkencore shqiptare

Ky bashkëpunim, përgjithësisht sporadik, është realizuar kryesisht në formën e leksioneve e seminareve, organizimit dhe pjesmarrjes në konferenca, projekteve të përbashkëta, konsulencave, artikujve të përbashkët, marrjen e të dhënave për punën shkencore, ndonjë udhëheqje doktorate apo shkëmbim experience. Ai është zhvilluar kryesisht mbi bazën e njohjeve personale, inisiativave individuale dhe jo në rrugë institucionale. Elira, një kërkuese shkencore në një nga vendet e BE, dëshmon në intervistën e saj: "Unë aktualisht bashkëpunoj me fakultetin (...), por kjo është thjesht nga kontaktet që kam personalisht me ish profesorët e mij të universitetit. (...) Unë jam pjesë e një bordi editorial ku pranoj (ose jo) dhe redaktoj artikujt që dërgohen për botim. Kjo është një punë që unë e bëj vullnetarisht, sepse dua të ndihmoj institucionin. Ka qenë thjesht editori i asaj gazete që ka marrë kontakte me mua, por asnjë lloj institucioni nuk më ka kërkuar bashkëpunim. Nuk më kanë kërkuar as për leksione."

Ndërkaq, 88 përqind e PhD shqiptare të anketuar nga Shqipëria dhe thuajse 93 përqind nga Kosova shprehen se dëshirojnë të bashkëpunojnë me universitetet dhe institucionet shkencore në vendin e origjinës (Tabela 4).

Tabela 4. Dëshira për bashkëpunim me universitetet dhe institucionet shkencore

Nr	Bashkëpunimi	Shqipëri	Kosovë
1	Po, dëshiroj të bashkëpunoj	88.1	92.9
2	Jo, nuk dëshiroj të bashkëpunoj	2.9	2.4
3	Pa përgjigje	9	4.7
	Total	100	100

Burimi: CESS, anketa me diasporën shkencore shqiptare

Madhësia e diasporës shkencore shqiptare rritet, po të mbajmë parasysh se rreth 92 përqind e PhD shqiptare nga Kosova dhe Maqedonia e Veriut që jetojnë në vendet e BE ose në Amerikën e Veriut dhe vende të tjera, gjithashtu dëshirojnë të bashkëpunojnë me universitetet dhe institucionet shkencore në Shqipëri (Tabela 5). Në intervistën e tij, Ahmeti një shqiptar nga Kosova dhe pedagog i informatikës në Gjermani, shprehet: "Unë kam marrë pjesë në disa inisiativa dhe jam përpjekur që të krijoj lidhje me kolegët në Shqipëri apo Kosovë (...)."

Tabela 5. Dëshira për bashkëpunim me universitetet/institucionet shkencore në Kosovë/Shqipëri

Nr	Bashkëpunimi	Shqipëri	Kosovë
1	Po, dëshiroj të bashkëpunoj	74.2	92.4
2	Jo, nuk dëshiroj të bashkëpunoj	7.3	1.2
3	Pa përgjigje	18.5	6.4
	Total	100	100

Burimi: CESS, anketa me diasporën shkencore shqiptare

Këto forma bashkëpunimi mund të shtrihen edhe me universitetet dhe institucionet shkencore në Kosovë dhe Maqedoni. Të dhënat e anketës tregojnë se 74 përqind e diasporës shkencore shqiptare është e gatshme të bashkëpunojë me këto institucione.[22] Këtë gjë pohon edhe Indriti, një profesor ekonomie në një universitet të njohur të ShBA: "Do të shkoja me shumë dëshirë në Kosovë, por edhe në universitetin e Tetovës. (...) Ndihem i mirëpritur në Kosovë, megjithëse nuk kam asnjë lidhje dhe njohje ..."

Pengesat

Sipas intervistave, edhe bashkëpunimi midis diasporës shkencore shqiptare dhe universiteteve e institucioneve shkencore në Shqipëri, ashtu si dhe në vende të tjera,[23] ndesh në pengesa dhe vështirësi. Këto pengesa dhe vështirësi nuk janë vetëm të natyrës financiare, por lidhen kryesisht me interesat, mentalitetin dhe mediokritetin e disa prej drejtuesve të universiteteve dhe institucioneve shkencore.

Kjo indiferencë dhe sjellje padyshim ngjall zhgënjim tek diaspora shkencore shqiptare dhe frenon bashkëpunimin. Shumë nga të intervistuarit mendojnë se kolegët e tyre në Shqipëri "duke e ditur sa rigoroz është programi i studimeve në universitetet perëndimore dhe sa punë e mund na duhet ne për tu përgatitur në fakultet mund të ndihen pak inferiorë". Ose sipas intervistës të Eltonit që është profesor në një universitet në SHBA: "Ndoshta i tremb cilësia e mësimdhënies, por dhe standartet si mënyra se si pyeten studentët në provime, vlerësimi i tyre, mënyra se si jepet lënda, përfshirja e studentëve në diskutim gjatë leksionit, (...)."

[22] Pyetja që ju bë të anketuarëve ishte: A dëshironi të bashkëpunoni me institucionet universitare dhe shkencore në Kosovë, publike dhe private?
[23] Teferra D. (2005) Brain circulation: unparalleled opportunities, underlying challenges, and outmoded presumptions, Journal of Studies in International Education, 9(3): 229–250.

Ndërkaq, universitetet dhe institucionet kërkimore gjenden para një dileme kritike: në rast se dëshirojnë të rrisin cilësinë e mësimdhënies dhe të kërkimit shkencor duhet të bashkëpunojnë gjithnjë e më shumë me diasporën shkencore shqiptare. Një bashkëpunim që ka përfitime të mëdha dhe kosto të vogël. Në rast të kundërt, ato do të vazhdojnë të vegjetojnë edhe në të ardhmen, çka do të ketë pasoja negative edhe në rritjen ekonomike dhe zhvillimin social të vendit.

Rrjedhimisht bashkëpunimi i qëndrueshëm dhe afat-gjatë i diasporës shkencore shqiptare me universitetet dhe institucionet shkencore në Shqipëri kërkon, së pari, një reformim të thellë të institucioneve shqiptare dhe një ndryshim radikal të mentalitetit. Ai kërkon gjithashtu edhe krijimin e një mjedisi miqësor, komunikim të vazhdueshëm midis palëve, diskutimin e ideve dhe të inisiativave, të cilat mund të dalin nga poshtë dhe të institucionalizohen nga sipër.

Metodologjia

Nga pikpamja metodologjike studimi bazohet në rishikimin e literaturës, dhe gërshetimin e teknikave sasiore dhe cilësore (cross-reference).[24] Teknikat sasiore përfshijnë tre vrojtime të realizuara pjesërisht face-to-face dhe pjesërisht on-line në Shqipëri dhe Kosovë me tre grupe të mëdha aktorësh a) universitetet dhe institucionet shkencore; b) ministritë dhe agjensitë shtetërore; dhe c) bashkitë/komunat. Ndërsa teknikat cilësore përfshijnë intervista dhe grupe diskutimi të realizuara kryesisht me drejtues të universiteteve e institucioneve shkencore, të ministrive dhe agjensive shtetërore, ashtu si dhe bashkive/komunave në Shqipëri dhe Kosovë.

Studimi ka shfrytëzuar edhe një bankë të madhe të dhënash të CESS-it për përfaqsuesit e diasporës shkencore shqiptare nga Shqipëria dhe Kosova.[25] Këto të dhëna sasiore u përpunuan dhe u analizuan në mënyrë që të theksoheshin disa karakteristika të diasporës shkencore shqiptare, si për shembull shpërndarja e saj gjeografike, fushat e studimit dhe dinamika e përfundimit të studimeve për PhD, vendi i punësimit, niveli dhe format e dëshiruara të bashkëpunimit me institucionet në Shqipëri dhe Kosovë, etj. Nëpërmjet këtyre të dhënave u mat edhe potenciali i bashkëpunimit të diasporës shkencore e profesionale shqiptare me institucionet në Shqipëri dhe Kosovë.

[24] Të gjitha burimet e literaturës së përdorur janë listuar në bibliografi.
[25] Gëdeshi I., King R., Research Study on Brain Gain, Reversing Brain Drain with Albanian Scientific Diaspora, UNDP, 2018; Gëdeshi I., King R., (2019) 'The Albanian scientific diaspora: can the brain drain be reversed?' Migration and Development, DOI:10.1080/21632324.2019.1677072.

Teknikat sasiore

Për të siguruar të dhëna sasiore lidhur me nevojat e institucioneve në Shqipëri dhe Kosovë u realizuan tre vrojtime statistikore. Vrojtimi i parë statistikor lidhet me universitetet dhe institucionet shkencore. Këtij vrojtimi iu përgjigjën 22 drejtues të universiteteve, fakulteteve dhe institucioneve shkencore në Shqipëri dhe 12 në Kosovë.

Pyetjet kryesore që ju drejtuam drejtuesve të institucioneve universitare dhe shkencore shqiptare lidhen me nevojat e tyre për ekspertë nga diaspora shkencore dhe profesionale (lektorë, ekspertë për hartim projektesh, udhëheqës PhD, hartim curriculash të reja, prakticienë, peer review, etj), nëse kanë mundësi t'ju krijojnë kushte pune në institucionet e tyre, dëshirën për të bashkëpunuar me institucionet nga vijnë profesionistët e diasporës, vlerësimin e ndonjë eksperience të mëparshme bashkëpunimi, etj. [26]

Vështirësia kryesore në këtë vrojtim ishte se disa drejtues të institucioneve universitare (kryesisht në Shqipëri) ishin të porsa emëruar në detyrë dhe nuk i njihnin siç duhet nevojat. Kjo vështirësi u kapërcye pjesërisht duke kontaktuar drejtues të departamenteve ose ish drejtues të institucioneve universitare. Krahas plotësimit të të dhënave sasiore të anketës shumë prej drejtuesve të institucioneve akademike dhe shkencore në anketën e dërguar bënë edhe komente ose shprehën mendime për bashkëpunimin me përfaqësuesit e diasporës shkencore shqiptare. Ky zë i tyre është analizuar dhe pasqyruar në studim.

Vrojtimi i dytë statistikor lidhet me disa ministri dhe agjensi shtetërore. Kësaj ankete iu përgjigjën 10 institucione në Shqipëri dhe 8 a shumë e njëjta metodologji si në rastin e institucioneve akademike dhe shkencore.

Përgjithësisht u kontaktuan drejtëpërdrejtë ose nëpërmjet emailit drejtues të ministrive dhe agjensive shtetërore.

Anketa përmbante pyetje ose grupe pyetjesh nëpërmjet të cilave u siguruan të dhëna sasiore për nevojat e ministrive/agjensive shtetërore për ekspertë në hartimin e politikave, për integrimin europian, për hartimin dhe zbatimin e projekteve, për monitorimin dhe zbatimin e politikave, për kostimin e politikave, për hartimin e standarteve, etj. Gjithashtu drejtuesit e ministrive u pyetën për eksperiencat e mëparshme, krijimin e kushteve të punës dhe si e vlerësonin dobinë e ekspertëve nga diaspora shqiptare.

Ndërsa vrojtimi i tretë u realizua me drejtuesit e bashkive/komunave. Thuajse 11 bashki/komuna të mëdha, të mesme dhe të vogla u anketuan në Shqipëri (Koplik, Shkodër, Kukës, Burrel, Tiranë, Kamëz, Durrës, Belsh, Korçë, Vlorë, Gjirokastër) dhe 11 në Kosovë (Skënderaj, Gjakovë, Vushtri, Pejë, Fushë Kosovë, Obiliq, Lipjan, Klinë, Hani i Elezit, Gjilan, dhe Kamenicë). Këto të dhëna u grumbulluan nga drejtuesit e bashkive/komunave dhe përmbanin informacion lidhur me nevojat e institucionit për ekspertë nga diaspora shqiptare në fushën e urbanistikës, në zhvillimin e qëndrueshëm, në përpunimin e mbetjeve, në shërbimet sociale, në hartim projektesh, për marrdhëniet me diasporën, etj. Pyetjet e tjera përfshinin kushtet e punës, eksperiencat e mëparshme me përfaqsues të diasporës shkencore, anët pozitive të këtij bashkëpunimi, pengesat e mundshme në këtë bashkëpunim, format e bashkëpunimit, etj. Disa nga drejtuesit e bashkive/komunave dhanë edhe komente të vlefshme gjatë plotësimit të anketës. Një pjesë të tyre ne i kemi pasqyruar në raport.

[26] Shiko anketën në Aneksin 1.

Teknikat cilësore

Krahas teknikave sasiore u realizuan edhe intervista dhe grupe diskutimi me drejtues të universiteteve ne Tiranë, Elbasan, Korçë, Gjirokastër, Vlorë, Durrës, dhe Shkodër. Disa intervista të tjera u realizuan me drejtues të ministrive dhe bashkive/komunave. Nëpërmjet intervistave dhe grupeve të diskutimit u grumbullua informacion cilësor lidhur me nevojat e institucioneve për ekspertë nga diaspora shkencore e profesionale, format e bashkëpunimit, eksperiencën e mëparshme, etj.

Një pjesë e këtyre intervistave janë regjistruar, transkriptuar dhe analizuar. Të gjithë emrat që citohen nga intervistat ose grupet e diskutimit në studim janë fiktivë dhe procedura standarte janë zbatuar për të ruajtur konfidencialitetin e kontributit të pjesmarrësve.

Nevojat e institucioneve

[29]

Institucionet publike në Shqipëri dhe Kosovë, në bazë të karakteristikave të tyre, ne i ndamë në tre grupe të mëdha. Në grupin e parë ne përfshimë universitetet, shkollat e larta dhe institucionet kërkimore, të cilat janë të shpërndara në qytetet kryesore. Në grupin e dytë përfshimë ministritë, agjensitë shtetërore dhe disa institucione të larta (presidenca, kuvendi, etj). Ndërsa në grupin e tretë bëjnë pjesë bashkitë/komunat. Nëpërmjet teknikave sasiore dhe cilësore, të cilat i shpjeguam tek metodologjia, ne u munduam të masim nevojat e tyre për ekspertizë nga diaspora shkencore dhe profesionale shqiptare.

Nevojat e universiteteve dhe institucioneve shkencore

Grupi i parë dhe më i madh i aktorëve që ne vrojtuam janë universitetet, shkollat e larta dhe institucionet shkencore në Shqipëri dhe Kosovë.Në Shqipëri ne anketuam universitetet në Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Korçë, Gjirokastër dhe Vlorë. Ndërsa në Kosovë u anketuan universitetet në Gjakovë, Mitrovicë, Prizren, dhe Prishtinë.

Vlerësimi i nevojave për ekspertë

Vlerësimi i nevojave për ekspertë të diasporës shkencore e profesionale nga universitetet dhe institucionet shkencore u realizua nëpërmjet anketës me drejtuesit e tyre. Duke i vlerësuar me notë nevojat e tyre (nga 1, minimalja në 5, maksimalja) vërejmë se pikët më të larta në Shqipëri janë për 'ekspertë për hartim projektesh' (4.3 pikë), 'udhëheqje doktoraturash' (3 pikë), 'lektorë' (3 pikë) dhe 'hartim curriculash të reja' (2.9 pikë). Ndërsa nevojat për 'vlerësues' (2.7 pikë) dhe 'prakticienë/laborantë' (2.5 pikë), siç shihet nga Figura 9, janë më të vogla.

Pavarësisht nga ky vlerësim sasior me pikë, shumë rektorë dhe dekanë në komentet e tyre në anketë ose në intervistat e zhvilluara theksuan në mënyrë më të detajuar nevojat e institucioneve të tyre për lektorë në degët e reja të shkencës, në metodat e reja shkencore dhe në disa fusha ku mungon eksperienca nga universitetet shqiptare. Lektorët nga diaspora shkencore, të cilët vijnë nga universitete dhe institucione shkencore të vendeve të BE, e pasurojnë jetën akademike dhe u japin studentëve të rejat e fundit të shkencës. Pranvera, një drejtuese fakulteti në Universitetin Politeknik të Tiranës, shkruan në anketën e saj: "Ne mirëpresim lektorë dhe ekspertë nga çdo fushe inxhinierike. Por nevojat për lektorë nga diaspora shkencore shqiptare më tepër do të konsistonin në shkëmbime përvojash dhe eksperiencash si dhe qasja ndaj metodikave mësimdhënëse, kërkimit shkencor, etj."

Figura 9. Nevojat për ekspertë të universiteteve/fakulteteve në Shqipëri



Burimi: Anketa për nevojat e universiteteve, 2020

Në disa universitete/fakultete, si në Tiranë, Vlorë dhe Durrës u theksua nevoja e prakticienëve/laborantëve nga diaspora shkencore, sidomos në veterinari (Tiranë), turizëm (Durrës) dhe infermieri (Vlorë). Rrjedhimisht nevojat janë të ndryshme dhe shpesh nuk mund të maten në rang kombëtar, por duhen analizuar për çdo fakultet në veçanti.

Figura 10. Nevojat për ekspertë të universiteteve/fakulteteve në Kosovë



Burimi: Anketa për nevojat e universiteteve, 2020

Ndërsa në Kosovë (Figura 10) vlerësimet më të larta nga rektorët dhe dekanët (ose zëvendësit e tyre) janë për 'ekspertë për hartim projektesh' (4.1 pikë), 'hartim curriculash të reja' (3.1 pikë) dhe 'lektorë' (2.3 pikë).

Një krahasim midis Shqipërisë dhe Kosovës, siç shihet në Tabelën 6, tregon se ka dallime dhe diferenca në vlerësimin e nevojave midis tyre. Përgjithësisht Shqipëria ka një kërkesë më të lartë për ekspertë të diasporës shkencore në krahasim me Kosovën (me përjashtim të zërit 'hartim curriculash të reja) dhe diferenca midis tyre shkon nga 0.2 (ekspertë për hartim curriculash të reja dhe vlerësues) në 0,7 (lektorë).

Tabela 6. Nevojat për ekspertë të universiteteve/fakulteteve në Shqipëri dhe Kosovë

Nr	Nevojat e universiteteve	Shqipëria	Kosova	Diferenca
1	Lektorë	3	2.3	0.7
2	Ekspertë për hartim projektesh	4.3	4.1	0.2
3	Udhëheqje doktorature	3	2.4	0.6
4	Hartim curriculash të reja	2.9	3.1	-0.2
5	Prakticienë/laboratorë	2.5	2.1	0.4
6	Vlerësues (peer revieëers)	2.7	2.5	0.2
7	Tjetër (përshkruaje)	1.1		

Burimi: Anketa për nevojat e universiteteve, 2020

Eksperiencat e mëparshme

Universitetet në Shqipëri dhe Kosovë kanë bashkëpunuar edhe më parë me përfaqësues të diasporës shkencore e profesionale shqiptare. Sipas anketës thuajse 75 përqind e universiteteve në Shqipëri dhe 66 përqind e atyre në Kosovë thonë se kanë eksperienca të mëparshme bashkëpunimi. Ky bashkëpunim ka qënë në formën e pjesmarrjes në konferenca ndërkombëtare, leksione të hapura, dhënjen e metodikave bashkëkohore të analizës, artikuj të përbashkët, pjesmarrje në projekte kërkimore, etj.[27] Ermira, një drejtuese në Universitetin Politeknik të Tiranës, thotë: "Këta ekspertë dhe profesorë kanë ndihmuar në vendosjen e urave të bashkëpunimit midis institucionve të arsimit të lartë, konkretisht universitetit tonë dhe universitetit në shtetin ku jetojnë dhe punojnë. (...) Përvoja jonë e deritanishme ka treguar se ekpertët nga diaspora kanë qenë ambasadorë të rëndësishëm të Shqipërisë në fushën e arsimit të lartë." Por ky bashkëpunim shpesh ka qënë sporadik, jo-institucional, ka angazhuar një numër të vogël ekspertësh nga diaspora shkencore/profesionale dhe në disa raste nuk ka vazhduar me inisiativa të mëtejshme. Një nga pengesat kryesore të këtij bashkëpunimi, sipas intervistave, ka qënë ana financiare.

[27] Sipas një interviste në Universitetin Bujqësor, Kamëz.

Rritja e performancës së universiteteve

Bashkëpunimi midis universiteteve në Shqipëri dhe Kosovë me diasporën shkencore shqiptare shikohet si një mundësi që do të rrisë cilësinë dhe performancën e universiteteve. Sipas anketës thuajse 100 përqind e drejtuesve të universiteteve/fakulteteve pohojnë se nga ky bashkëpunim performanca e institucioneve akademike dhe shkencore do të rritet. Sipas tyre, ky bashkëpunim do të ndikojë në rritjen e kompetencave të stafeve universitare, në futjen e metodave bashkëkohore në procesin e mësimit, në rritjen e botimeve shkencore në revista të njohura ndërkombëtare, në udhëheqjen cilësore të PhD, në pjesmarrjen në projekte kërkimore ndërkombëtare, në shkëmbimin e përvojave, në organizimin e workshopeve dhe konferencave ndërkombëtare, etj. Këtë thekson edhe Mirjeta, një nga drejtuesit e Universitetit Bujqësor në Kamëz, e cila shkruan: "Eksperti nga diaspora do të sjellë një frymë të re bashkëpunimi, mënyrë të menduari dhe të punuari. Performanca e institucionit do të rritet me botimet, punimet shkencore të indeksuara në Scopus, Tomson & Reuters."

Bashkëpunimi me diasporën shkencore shqiptare shihet nga shumë drejtues të përkushtuar edhe si një nga rrugët kryesore për të dinamizuar dhe rritur cilësinë e universiteteve. Edlira, një drejtuese tjetër, shkruan: "Studiuesit shqiptarë duhet ti thërrasim në mënyrë të vazhdueshme në mënyrë që kontributi i tyre të jetë sa më frytdhënës. Kjo është mënyra më e mirë për të ndihmuar universitetet tona."

Lidhjet institucionale

Bashkëpunimi me diasporën shkencore e profesionale shqiptare shihet nga shumë drejtues të universiteteve edhe si një mundësi për të krijuar kontakte dhe vendosur lidhje të reja institucionale me universitete, laboratore e institucione shkencore në vendet e BE. Thuajse të gjithë drejtuesit e anketuar dhe të intervistuar dëshirojnë të vendosin nëpërmjet përfaqsuesve të diasporës shkencore lidhje të qëndrueshme dhe bashkëpunim me universitetet/institucionet shkencore ku ata punojnë.

Bashkëpunimi midis institucioneve në këtë rast do të ndihmonte në gjetjen e fondeve nga BE për projekte të përbashkëta kërkimore, akses në banka të dhënash online, trajnime, shkëmbime studentësh dhe doktorantësh në fushat e përbashkëta, shkëmbime pedagogësh dhe programe mësimore të përbashkëta, organizimin e konferencave shkencore, diploma studentësh të përbashkëta, etj. [28]

[28] Intervista me dekanë të fakulteteve në Universitetin Bujqësor në Kamëz dhe me drejtues në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Krijimi i kushteve të punës

Krijimi i kushteve të punës është një element i rëndësishëm për bashkëpunimin me diasporën shkencore. Thuajse 42 përqind e drejtuesve të universiteteve në Shqipëri dhe 58 përqind në Kosovë shprehen se mund tu krijojnë kushtet e punës për ekspertin nga diaspora shkencore (Tabela 7). Të tjerët mund të krijojnë një pjesë të tyre ose nuk kanë mundësi.

Tabela 7. Krijimi i kushteve të punës për ekspertët e diasporës shkencore në universitete

Sigurimi i kushteve të punës	Po	Jo	Disi	Nuk e di
Universitetet në Shqipëri	42	8	50	0
Universitetet në Kosovë	58	25	0	17

Burimi: Anketa për nevojat e universiteteve, 2020

Ndërkaq, në intervista apo focus grupe shumë të tjerë shprehen se e rëndësishme është edhe krijimi i një mjedisi miqsor, ku eksperti nga diaspora shkencore e profesionale dhe stafet universitare të gjejnë frymën e bashkëpunimit dhe të ndërmarrin inisiativa të përbashkëta afat-gjata.[29]

Nevojat e ministrive dhe agjensive shtetërore

Grupi i dytë i aktorëve përbëhet nga ministritë dhe agjensitë shtetërore në Shqipëri dhe Kosovë, të cilat kanë nevoja specifike për ekspertë nga diaspora shkencore dhe profesionale në fusha të caktuara.

Sipas rezultateve të anketës, vlerësimi me notë i nevojave të tyre në Shqipëri (Figura 11) tregon se ato duan më shumë ekspertë nga diaspora shkencore dhe profesionale për implementimin e politikave (4.4 pikë), hartimin e standarteve (4 pikë), hartimin e politikave (3.9 pikë), monitorimin dhe kostimin e politikave (3.8 pikë secila).

Figura 11. Vlerësimi i nevojave për ekspertë të ministrive në Shqipëri



Burimi: Anketa për nevojat e ministrive, 2020

[29] Sipas intervistave me drejtues të fakulteteve në Universitetin "Luigj Gurakuqi" në Shkodër

Ndërsa nga Kosova (Figura 12) nevojat më të mëdha për ekspertë janë për hartim politikash (3.6 pikë), vlerësim politikash (3.6 pikë), zbatimin dhe kostimin e politikave (3.3 pikë secili).

Figura 12. Vlerësimi i nevojave për ekspertë të ministrive në Kosovë



Burimi: Anketa për nevojat e ministrive, 2020

Nevojat për ekspertë nga diaspora shkencore dhe profesionale shqiptare, siç e tregon edhe Tabela 8, vlerësohen mesatarisht më shumë në Shqipëri se sa në Kosovë. Krahas faktorëve subjektivë (të cilët janë të pashmangshëm në një vlerësim të tillë) ne do të tregojmë pak më poshtë, kur të flasim për nevojat e bashkive dhe komunave, disa nga faktorët objektivë që ndikojnë në një vlerësim të tillë.

Tabela 8. Vlerësimi i nevojave specifike të ministrive dhe agjensive shtetërore në Shqipëri dhe Kosovë

Nr	Nevojat e universiteteve	Shqipëria	Kosova	Diferenca
1	Ekspertë për hartim politikash	3.9	3.6	0.3
2	Ekspertë për integrimin europian	3.7	2.7	1.0
3	Ekspertë për implementimin e politikave	4.4	3	1.4
4	Ekspertë për hartimin dhe zbatimin e projekteve	3.4	3	0.4
5	Ekspertë për monitorimin dhe zbatimin e politikave	3.8	3.3	0.5
6	Ekspertë për vlerësimin e politikave	3.7	3.6	0.1
7	Ekspertë për kostimin e politikave	3.8	3.3	0.5
8	Ekspertë për hartimin e standarteve	4	3.1	0.9
9	Tjetër (specifiko)			

Burimi: Anketa për nevojat e ministrive, 2020

Vlerësimi për ekspertët e diasporës shkencore/profesionale shqiptare

Thuajse 90 përqind e drejtuesve të anketuar thonë se ekspertët nga diaspora shkencore/-profesionale janë të vlefshëm për institucionet e tyre. Sonila, një nga drejtuesit e një prej ministrive të Shqipërisë, shkruan në anketën e saj: "Ministria jonë ka bashkëpunim të vazhdueshëm me ekspertë të fushës akademike dhe shkencore të Shqipërisë. Bashkëpunimi me ekspertë nga diaspora shkencore shqiptare do të ishte një vlerë e shtuar dhe mundësi shumë e mirë për të krijuar një standard të ri cilësor jo vetëm në nivel kombëtar, por edhe ndërkombëtar."

> ***"Institucionet shqiptare janë të afta dhe të përgatitura për të hartuar dhe zbatuar të gjitha detyrat që i kërkohen, por shpesh herë ngarkesat dhe problematikat e papritura i bëjnë që të mos arrijnë në kohën e duhur për të përballuar të gjitha sfidat. Prezenca e ekspertëve të diasporës, do të sjellë frymë të re bashkëpunimi, mënyra të reja qasjeje dhe përballimi të vështirësive.***
>
> ***Ekspertët nga diaspora të cilët kanë përballuar vështirësi dhe kanë arritur të afirmohen në vendet pritëse, kanë motivimin dhe eksperiencën e duhur për të kaluar vështirësitë. Ndryshe nga ekspertët vendas, të cilët duke mos u përballur me sfidat e vendeve të tjera janë të kufizuar në vizionin e tyre. Një bashkim i këtyre dy lloj ekspertësh do të krijonte një qasje të re, ndryshe nga bashkëpunimi me ekspertët e huaj."***
>
> ***Intervistë me një zëvendës-ministër në Shqipëri***

Eksperienca e mëparshme

Sipas anketës, thuajse 28 përqind e institucioneve nga Shqipëria dhe 57 përqind e atyre nga Kosova kanë patur eksperienca të mëparshme me përfaqsues të diasporës shkencore dhe profesionale. Në Shqipëri, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural ka patur një eksperiencë të sukseshme me ekspertë
të diasporës shkencore të cilët punonin në
të diasporës shkencore të cilët punonin në
Kennedy School of Governance në Universitetin e Harvardit. Ministria e Drejtësisë në Kosovë ka patur një eksperiencë me studentë shqiptarë që studionin në vende të ndryshme të BE dhe në SHBA. Sidoqoftë këto eksperienca, pavarësisht vlerësimeve pozitive, kanë qënë të pakta, të rastit, dhe nuk kanë mundur të japin një impakt të dukshëm në punën e institucioneve të vrojtuara.

Anët pozitive të ekspertëve të diasporës shkencore shqiptare

Sipas anketës thuajse 43 përqind e drejtuesve të ministrive mendojnë se ekspertët e diasporës shkencore janë më të vlefshëm se ekspertët e huaj, në rast se ekspertiza dhe eksperienca e tyre është e njëjtë.

Tabela 9. Mendoni se ekspertët nga diaspora shkencore/profesionale shqiptare do të ishin më të vlefshëm se ekspertët e huaj që vijnë në Shqipëri? (në %)

Nr		Po	Jo	Varet	Nuk e di
1	Shqipëria	44	0	56	0
2	Kosova	43	0	57	0

Burimi: Anketa për nevojat e ministrive, 2020

Përfaqsuesit e ministrive u pyetën nëpërmjet anketës dhe intervistave edhe për ndryshimin që ekziston midis ekspertëve të huaj dhe ekspertëve të diasporës shkencore shqiptare. Sipas vlerësimeve të tyre, ekspertët e diasporës shkencore e "njohin më mirë kontekstin lokal, fazën e zhvillimit socio-ekonomik të vendit, ashtu si dhe problematikat lidhur me zbatimin e politikave" (Ministria e Kulturës, Shqipëri) dhe rrjedhimisht "mund të japin një ekspertizë në përputhje me realitetin shqiptar" (Ministria e Turizmit, Shqipëri). Ata njohin "realitetin e vendit, mentalitetin e popullsisë dhe komunikojnë në shqip me stafin" (Ministri i Shtetit për Diasporën, Shqipëri).

Ekspertët e diasporës shkencore janë "më të ndjeshëm ndaj rezultateve dhe impaktit të projektit" (Ministria e Kulturës, Shqipëri) dhe "venë në plan të parë interesin kombëtar" (Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Shqipëri). Të tjerë theksojnë "dashurinë për vendin dhe gadishmërinë për të dhënë maksimumin" (Ministria e Mbrojtjes, Kosovë). Të gjitha këto bëjnë që eksperti nga diaspora shqiptare të ketë "një motivim moral më tepër pasi po kontribuon për vendin e tij, ndryshe nga eksperti i huaj që e konsideron thjesht detyrim të punës dhe të kushteve të kontratës" (Ministria e Turizmit, Shqipëri).

Kushtet e punës

Ekspertët e diasporës shkencore kanë nevojë për kushte pune në institucionet pritëse. Këto kushte pune përfshijnë pasjen e një vendi pune, tavolinë dhe computer, ashtu si dhe infrastrukturën e nevojshme (internet, telefon, etj). Sipas anketës 71 përqind e drejtuesve të ministrive thonë se mund tu krijojnë kushte pune përfaqsuesve të diasporës shkencore, 14 përqind thonë se nuk kanë mundësi dhe 14 përqind të tjerë thonë se 'nuk e dinë'.

Nevojat e bashkive/komunave

Grupi i tretë i aktorëve të anketuar përbëhet nga bashkitë/komunat, të cilat shprehin nevojat e institucioneve në nivel lokal. Bazuar tek anketa drejtues të bashkive/komunave në Shqipëri dhe Kosovë vetë-vlerësuan me notë (nga 1 deri në 5) nevojat e tyre për ekspertë nga diaspora shkencore dhe profesionale shqiptare në fushat kryesore të veprimtarisë së tyre. Pavarësisht nga karakteri subjektiv që mund të vërehet në ndonjë rast anketa tregon nevojat prioritare të bashkive/komunave, të vetëvlerësuara në bazë pikësh, dhe që duhen plotësuar me ekspertë të kualifikuar, bazuar tek renditja. Kjo do të rriste efektivitetin e ndihmës nga ekspertët e diasporës shkencore e profesionale shqiptare.

Në rast se i përmbledhim këto vetëvlerësime dhe nxjerrim një notë mesatare lidhur me nevojat për ekspertë nga diaspora shkencore/-profesionale të bashkive në Shqipëri vërejmë se notën më të lartë e marrin ekspertët për hartim projektesh (4.8 pikë), turizmin (4.8 pikë), bujqësinë (4.6 pikë) dhe përpunimin e mbetjeve (4.5 pikë). Këto fusha janë prioritare për shumë bashki në Shqipëri dhe kërkojnë ekspertizë dhe ide të reja për tu zhvilluar. Kështu, sipas intervistave të realizuara rezulton se bashkitë nuk kanë ekspertizë të mjaftueshme në fushën e hartimit të projekteve dhe rrjedhimisht shumë prej tyre nuk konkurrojnë dhe nuk marrin pjesë në projektet e financuara nga BE ose në projektet e bashkëpunimit rajonal

Kjo privon shumë bashki nga fondet e BE dhe eksperienca që mund të përfitohej nga bashkëpunimi rajonal. Bashki të tjera vlerësojnë si prioritare zhvillimin e turizmit ose të bujqësisë[30] dhe rrjedhimisht kanë nevojë për ekspertë nga diaspora shkencore e profesionale shqiptare të këtyre fushave.

Ndërsa nevojat për ekspertë për shërbimet sociale (3.4 pikë) dhe urbanistikë (3.6 pikë), ku ata kanë një eksperiencë, marrin notën më të ulët. Notë të ulët merr edhe ekspertiza për diasporën (3.7 pikë), e cila është një fushë e re për shumicën e bashkive në Shqipëri dhe, sipas mendimit tonë, nuk vlerësohet sa duhet. Bashkëpunimi me diasporën mund tu jepte bashkive, sidomos atyre të vogla dhe me burime ekonomike më të pakta, kapital të ri financiar (kursimet e emigrantëve), human dhe social, i cili mund të përdorej për zvillimin lokal (Figura 13).

Figura 13. Vlerësimi i nevojave për ekspertë të bashkive në Shqipëri



Burimi: Anketa për nevojat e bashkive/komunave, 2020

Ndërsa në Kosovë nevojat e komunave për ekspertë janë më të larta në përpunimin e mbetjeve (4 pikë), turizëm (3.8 pikë) dhe zhvillim të qëndrueshëm (3.6 pikë).

Ndërsa janë më të ulta për shërbimet sociale (2.6 pikë), diasporën (2.9 pikë) dhe hartim projektesh (3.2 pikë).

Figura 14. Vlerësimi i nevojave për ekspertë të komunave në Kosovë



Burimi: Anketa për nevojat e bashkive/komunave, 202

[30]Pas reformës territoriale të vitit 2014 bashkia përfshiu në territorin e saj edhe zonën

Ekzistojnë dallime në vlerësimin e nevojave për ekspertë të diasporës shkencore/profesionale sipas fushave prioritare midis bashkive në Shqipëri dhe komunave në Kosovë (Tabela 10).

Thuajse në të gjitha nevojat për ekspertë bashkitë në Shqipëri japin një vlerësim më të lartë se ato të komunave në Kosovë, por diferencat midis tyre janë më të mëdha për ekspertë për hartim projektesh (1.7 pikë) dhe ekspertë për bujqësinë (1.3 pikë).

Tabela 10. Vlerësimi i nevojave specifike të bashkive/komunave në Shqipëri dhe Kosovë

Nr	Nevojat e bashkive/komunave	Nota mesatare		Diferenca
		Shqipëria	Kosova	
1	Ekspertë për urbanistikë	3.6	3.5	0.1
2	Ekspertë për zhvillim të qëndrueshëm	4	3.6	0.4
3	Ekspertë për përpunimin e mbetjeve	4.5	4	0.5
4	Ekspertë për shërbimet sociale	3.4	2.6	0.8
5	Ekspertë për hartim projektesh	4.9	3.2	1.7
6	Ekspertë për diasporen	3.7	2.9	0.8
7	Ekspertë për bujqësinë	4.6	3.3	1.3
8	Ekspertë për mbrojtjen e mjedisit	4.1	3.5	0.6
9	Ekspertë për turizmin/trashëgimi në kulturore e historike	4.9	3.8	1.1
10	Tjetër (cilësoje)			

Burimi: Anketa për nevojat e bashkive/komunave, 2020

Pyetja që shtrohet është: Pse kjo diferencë në vlerësimin e nevojave për ekspertë midis Shqipërisë dhe Kosovës? Sipas intervistave dhe grupeve të diskutimit janë disa faktorë që mund të shpjegojnë këtë fenomen. E para ndër to' është emigrimi më i madh i elitave të profesionistëve ose brain drain nga Shqipëria në krahasim me Kosovën.

Një faktor tjetër është prania më e lartë e ekspertëve ndërkombëtarë në Kosovë në krahasim me Shqipërinë, çka shoqërohet edhe me një ekspertizë më të madhe ndërkombëtare në institucione. Të tjerë theksojnë se Kosova ka investuar më shumë në përgatitjen jashtë vendit të brezit të ri dhe niveli i kthimit të tyre në vendlindje ka qënë më i lartë se në Shqipëri.

Dëshira për bashkëpunim dhe krijimi i kushteve

Sipas anketës, të gjithë drejtuesit e bashkive/-komunave, në Shqipëri dhe Kosovë, vlerësojnë dhe janë të gatshëm të bashkëpunojnë me ekspertët e diasporës shkencore/profesionale shqiptare. Disa prej tyre theksojnë se "kjo do të ishte një vlerë e shtuar" (Komuna Gjakovë), do të sillte "ekspertizë dhe praktika të mira nga vendet më të zhvilluara të BE" (Komuna Hani i Elezit) ose "do të sillte një frymë të re dhe praktikat më të mira të vendeve të zhvilluara" (Bashkia Kamëz).

Bashkëpunimi me ekspertët e diasporës shkencore/profesionale shqiptare kërkon edhe krijimin e disa kushteve materiale, si zyra ku ata të kenë mundësi të punojnë, computer, dhe lehtësi të tjera infrastrukturore.

Por mbi të gjitha bashkëpunimi do të kërkonte krijimin e një mjedisi mikpritës, të ngrohtë, ndërveprues, ku përfaqsuesit e diasporës shkencore/profesionale të kenë mundësi të diskutojnë dhe të shprehin lirisht mendimet e tyre. Thuajse të gjitha bashkitë dhe komunat janë të gatshme të krijojnë kushtet materiale të punës për ekspertët e diasporës shkencore/profesionale. Por këto kushte varen edhe nga mundësitë ekonomike të bashkive/komunave. Kështu disa përfaqsues të bashkive/komunave të vogla shprehen se kanë vështirësi në sigurimin e computerave dhe sigurimin e lehtësive infrastrukturore.

Një eksperiencë e re

Bashkëpunimi me ekspertët e diasporës shkencore dhe profesionale shqiptare është një eksperiencë e re për shumicën e bashkive/komunave në Shqipëri dhe Kosovë. Më shumë se 60 përqind e bashkive/komunave, kryesisht ato të vogla dhe të mesme, nuk kanë pasur ndonjë eksperiencë të mëparshme me ekspertë nga diaspora shkencore/profesionale shqiptare. Në Shqipëri një bashkëpunim me ekspertë nga diaspora shkencore/profesionale shqiptare ka pasur bashkia Tiranë, por edhe në këtë rast bëhet fjalë për forma të thjeshta, si shkëmbim vizitash, etj. Ndërsa në Kosovë thuajse 27 përqind e komunave shprehen se kanë pasur një eksperiencë të mëparshme me ekspertë të diasporës shkencore/profesionale. Kjo eksperiencë ka qenë e lidhur me mbrojtjen e mjedisit dhe vlerave historike (Komuna Hani i Elezit) ose në vlerësimin e projekteve të rëndësishme për qytetin (Komuna e Kamenicës).

Nga bashkëpunimi individual në bashkëpunim institucional

Ky bashkëpunim midis bashkive/komunave dhe ekspertëve të diasporës shkencore/profesionale mund të zgjerohet duke vendosur kontakte ose bashkëpunim me institucionet ku ata punojnë në vendet pritëse.

Sipas anketës thuajse të gjitha bashkitë/komunat janë të gatshme të bashkëpunojnë në perspektivë me institucionet nga do të vijnë ekspertët e diasporës shkencore/profesionale. Në këtë rast ekspertët mund të shërbejnë si urrë lidhëse midis institucioneve.

Rrjedhimisht kjo do të ndikonte edhe në fuqizimin institucional të bashkive/komunave, në rrjetëzimin e tyre me institucione analoge në Gjermani ose në vende të tjera të BE dhe në pjesmarrjen në projekte të parbashkëta.

Gjysma (50 përqind) e drejtuesve të bashkive në Shqipëri e vlerëson më të dobishëm bashkëpunimin me ekspertët e diasporës shqiptare se sa me ekspertët e huaj (Tabela 11). Sipas intervistave ky vlerësim bazohet në faktin se ekspertët shqiptarë nga diaspora shkencore/profesionale i njohin më mirë kushtet ekonomiko-sociale të vendit, mentalitetin e popullsisë, komunikojnë në gjuhën amtare, mund të ndikojnë pozitivisht në grupe të caktuara të popullsisë, dhe se interesi i tyre nuk është thjesht material, por bazohet në ndjenjën e fortë të atdhedashurisë. Këtë thekson edhe Agimi, një nga drejtuesit e bashkisë Kukës, i cili shkruan në anketën e tij: "Ekspertët e diasporës shkencore shqiptare do të ishin më të vlefshëm se ekspertët e huaj që vijnë në Shqiperi pasi interesimi i tyre është edhe atdhetar, si dhe janë të njohur me kushtet ekonomike dhe sociale të vendit." Ndërsa në Kosovë pak më shumë se gjysma e drejtuesve të komunave vlerëson se kjo përcaktohet nga cilësia e ekspertizës profesionale që zotërojnë ekspertët dhe jo nga kombësia e tyre. Një drejtues komune shkruan në anketën e tij: "Unë nuk mendoj që ekspertët ndahen në bazë të nacionalitetit, ekspertizat e tyre janë njëlloj të vlefshme."

Tabela 11. Mendoni se ekspertët e diasporës shkencore/profesionale do të ishin më të vlefshëm se ekspertët e huaj? (në %)

Nr	Vendi	Po	Jo	Varet	Nuk e di
1	Shqipëria	50	0	37.5	12.5
2	Kosova	36.4	0	54.5	9.1

Burimi: Anketa për nevojat e bashkive/komunave, 2020

Konkluzione dhe rekomandime

Gjatë disa dekadave emigracioni shqiptar ka krijuar një diasporë shkencore dhe profesionale, të koncentruar në vendet më të zhvilluara të OCDE, të aftë e të gatshme të kontribuojë me dijet e saj në zhvillimin socio-ekonomik të Shqipërisë dhe Kosovës. Studimet e fundit tregojnë se potenciali human i diasporës shkencore e profesionale shqiptare është i diversifikuar, në rritje të shpejtë, i punësuar në universitete, laboratore, institucione shkencore, organizata ndërkombëtare dhe firma shumëkombëshe të vendeve pritëse. Ky potencial human i diasporës shqiptare duhet shfrytëzuar, nëpërmjet formave të ndryshme të bashkëpunimit, për të nxitur zhvillimin ekonomik e social të vendeve të origjinës.

Pavarsisht se institucionet shqiptare të vrojtuara (universitetet e institucionet shkencore, ministritë e agjensitë shtetërore, bashkitë/komunat) shprehen të gatshme të bashkëpunojnë me diasporën shkencore e profesionale shqiptare ekzistojnë disa pengesa të cilat duhen kapërcyer. Ato duhet të prioritizojnë nevojat reale të tyre, të krijojnë kushtet e punës dhe mjedisin e përshtatshëm social që një bashkëpunim i tillë të ndodhë dhe të jetë i frutshëm. Një nga pengesat kryesore që kanë institucionet shqiptare, ajo financiare, mënjanohet në këtë projekt nga ndërhyrja e GIZ.

Ky bashkëpunim duhet të mbajë parasysh nevojat reale të institucioneve dhe prioritetin e tyre në Shqipëri dhe Kosovë në mënyrë që rezultatet e tij të jenë të dukshme. Bashkëpunimi duhet të përgatitet me kujdes dhe të ketë objektiva të qarta dhe të realizueshme

Ky bashkëpunim duhet të vijojë me lidhje të qëndrueshme dhe afat-gjata midis institucioneve shqiptare me diasporën shkencore dhe profesionale. Ai duhet të vijojë edhe me krijimin dhe vendosjen e lidhjeve institucionale me institucionet ku punojnë përfaqsuesit e diasporës shkencore, çka do të afronte Shqipërinë dhe Kosovën me vendet e BE.

Një organizatë ose institucion i pavarur (në Shqipëri dhe/ose Kosovë) që koordinon 'kërkesën' dhe 'ofertën' ose bashkërendon punën midis diasporës shkencore e profesionale shqiptare, nga njëra anë, dhe institucioneve shqiptare, nga ana tjetër, është i nevojshëm. Ky institucion, nga njëra anë, duhet të krijojë dhe të rinovojë në mënyrë të vazhdueshme një Bankë të Dhënash për burimet humane të diasporës shkencore e profesionale shqiptare. Kjo bankë duhet të përmbajë disa nga të dhënat socio-demografike të personit, gradën shkencore, fushën e studimit, universitetet ku personi ka studiuar, eksperiencën dhe ekspertizën profesionale, ashtu si dhe vendin aktual të punës. Kjo Bankë të Dhënash mund të shërbejë edhe për të realizuar një hartëzim të diasporës shkencore shqiptare. Ndërsa, nga ana tjetër, kjo organizatë ose institucion i pavarur duhet të njohë nevojat reale (dhe prioritetin e tyre) të institucioneve shqiptare në Shqipëri dhe Kosovë.

Bashkëpunimi midis diasporës shkencore shqiptare dhe institucioneve në Shqipëri dhe Kosovë, sidomos në hapat e parë, duhet të përgatitet me kujdes, rast pas rasti, në bazë të një program të detajuar dhe me objektiva të qarta, në mënyrë që të jetë një histori suksesi. Në varësi të progresit ky bashkëpunim mund të zgjerohet edhe me institucione të tjera publike dhe private.

Bashkëpunimi midis diasporës shkencore dhe profesionale shqiptare dhe institucioneve në Shqipëri dhe Kosovë duhet të inkurajohet dhe dokumentohet edhe nëpërmjet mass-medias ku të tregohen përfitimet reciproke dhe historitë e suksesit.

Bibliografia

Arenliu et al., (2014) Kosovo Human Development Report (2014) United Nations Development Programme, Swiss Cooperation Office Kosovo https://www.ecoi.net/en/file/local/1079594/1226_1418899302_undp-kosovo.pdf

Gëdeshi I., (2008) The relationship between migration and socio-economic changes in Albania, Der Donauraum, 48(3): 197–292.

Gëdeshi I., Germenji E., (2008) Highly Skilled Migration from Albania: An Assessment of Current Trends and the Ways Ahead. Brighton: DRC Migration, Globalisation and Development, Working Paper T25.

Gëdeshi I., King R., (2018) Research Study on Brain Gain, Reversing Brain Drain with Albanian Scientific Diaspora. Tirana: UNDP.

Gëdeshi I., King R., (2019) 'The Albanian scientific diaspora: can the brain drain be reversed?' Migration and Development, DOI:10.1080/21632324.2019.1677072.

Gëdeshi I., King, R. (2018) New Trends in Potential Migration from Albania. Tirana: F. Ebert Foundation.

Gëdeshi I., Mara H., Dhimitri R., Krisafi K., (1999) Emigrimi i Elites Intelektuale nga Shqipëria gjatë Periudhës së Tranzicionit. Tirana: Shtëpia Botuese "Luarasi".

Horvat V., (2004) Brain drain threat to successful transition in South East Europe? South-East European Politics, 5(1): 76–93.

INSTAT., (2019) Diaspora e Shqipërisë në shifra. Tirana: INSTAT.

IOM., (2020) National Household Migration Survey in Albania. Tirana: IOM.

King R., Gëdeshi I., 'New trends in potential migration from Albania: the migration transition postponed', Migration and Development, 9(2), pp. 131–151, 2020.

King R., Gëdeshi I., (2020) The actual and potential migration of students from Albania: a putative brain drain? (forthcoming), F. Ebert Foundation.

Moguérou P., (2006) The Brain Drain of PhDs from Europe to the United States: What We Would Like to Know. Florence: European University Institute, RSCAS Working Paper 2006/11.

Temaj K., Krasniqi L., (2020) Engaging Albanian Diaspora Professionals. Prishtina: GERMIN.

Uraguchi et al, (2018), Diaspora Communities as a Driving force for Development: Is there a "Business case" HELVETAS.

World Bank (2016) Migration and Remittances Factbook 2016. Washington DC: World Bank.

World Bank (2010) Albania, the New Growth Agenda: A Country Economic Memorandum. Washington DC: World Bank Report No. 53599-AL.

Aneksi 1.

Pyetësor për bashkitë

Ne dëshirojmë të dijmë disa nga nevojat tuaja për ekspertë nga diaspora shqiptare që mund të punojnë vullnetarisht për periudha të shkurtra kohore në institucionin tuaj. Ju lutem përgjigjuni pyetjeve të mëposhtëme dhe jepni komentet tuaja.

1. Në tabelën e mëposhtëme vlerësoni me 1 deri në 5 nevojat tuaja (1 minimale dhe 5 maksimale)

Nr	Nevojat e bashkive	Shënoni me 1-5	Komente
1	Ekspertë për urbanistikë		
2	Ekspertë për zhvillim të qëndrueshëm		
3	Ekspertë për përpunimin e mbetjeve		
4	Ekspertë për shërbimet sociale		
5	Ekspertë për hartim projektesh		
6	Ekspertë për diasporen		
7	Ekspertë për bujqësinë		
8	Ekspertë për mbrojtjen e mjedisit		
9	Ekspertë për turizmin/trashëgiminë kulturore e historike/arkeologjinë		
10	Tjetër (cilësoje)		

2. Mendoni se ekspertët e diasporës shkencore shqiptare do të jenë të vlefshëm për institucionin tuaj?

- -

- -

- -

- -

3. Keni patur ndonjë eksperiencë të mëparshme me ekspertë nga diaspora shkencore shqiptare?

a. Po **b.** Jo **c.** Nuk e di

4. Nqse PO, a mund ta përshkruani me pak fjalë këtë eksperiencë?
Ku qëndron ana pozitive e saj?

5. Mendoni se ata do të ishin më të vlefshëm se ekspertët e huaj që vijnë në Shqipëri?

a. Po **b.** Jo **c.** Varet **d.** Nuk e di

Ju lutem shpjegoni vlerësimin tuaj:

6. A mund të krijoni kushte pune (zyre, tavoline pune, computer, etj) për ekspertët e diasporës shqiptare që mund të vijnë në institucionin tuaj?

a. Po **b.** Jo **c.** Nuk e di

7. A jeni të gatshëm të shkëmbeni eksperiencë me institucionet ku punojnë ekspertët e diasporës shqiptare?

a. Po **b.** Jo **c.** Nuk e di

8. Komente të tjera:

Pyetësor për universitetet/fakultetet

Ne dëshirojmë të dijmë disa nga nevojat tuaja për ekspertë nga diaspora shqiptare që mund të punojnë vullnetarisht për periudha të shkurtra kohore në institucionin tuaj.

1. Në tabelën e mëposhtëme vlerësoni me 1 deri në 5 nevojat tuaja (1 minimale dhe 5 maksimale)

Nr	Nevojat e universiteteve	Shënoni me 1-5	Komente
1	Lektorë		
2	Ekspertë për hartim projektesh		
3	Udhëheqje doktorature		
4	Hartim curriculash të reja		
5	Prakticienë/laboratorë		
6	Vlerësues (peer reviewers)		
7	Tjetër (përshkruaje)		

2. Në rast se kini nevojë për lektorë, kush janë fushat prioritare (ju lutem shkruani):

- -

- -

- -

- -

3. Institucioni juaj ka mundësi të sigurojë kushtet e punës (zyrë, paisje, etj) për ekspertin që vjen nga diaspora?

1. Po **2.** Jo **3.** Nuk e di

4. Eksperti që vjen nga diaspora mund t'ju krijojë lidhje me institucionin ku ai punon në vendin e emigrimit. Jeni të interesuar për vendosjen e lidhjeve shkencore/mësimore etj me institucionet e huaja?

1. po **2.** jo **3.** Nuk e di

5. Nëqoftëse PO, ju lutem përshkruani se cfarë lidhjesh dëshironi të vendosni:

6. Si e mendoni rolin e ekspertit nga diaspora? Cfarë roli mund të luajë ai në institucionin tuaj? Ju lutem përshkruajeni:

7. Mendoni se bashkëpunimi me ekspertët nga diaspora mund të rrisë performancën e institucionit tuaj?

1. Po **2.** Jo **3.** Nuk e di

8. Nëqoftëse PO, ju lutem përshkruani:

9. Deri tani, a keni pasur ndonjë bashkëpunim me ekspertë nga diaspora shqiptare?

1. Po **2.** Jo **3.** Nuk e di

10. Nqse PO, a mund të përshkruani anët pozitive të këtij bashkëpunimi, arritjet në performancën e institutit tuaj dhe pengesat që janë vërejtur?

11. Ky bashkëpunim ka vazhduar edhe pas largimit të ekspertit të diasporës?

1. Po, ka vazhduar

2. Jo nuk ka vazhduar

3. Nuk e di

12. Komente të tjera:

Pyetësor për ministrite/institucionet

Ne dëshirojmë të dijmë disa nga nevojat tuaja për ekspertë nga diaspora shqiptare që mund të punojnë vullnetarisht për periudha të shkurtëra kohore në institucionin tuaj.

1. Në tabelën e mëposhtëme vlerësoni me 1 deri në 5 nevojat tuaja (1 minimale dhe 5 maksimale)

Nr	Nevojat e universiteteve	Shënoni me 1-5	Komente
1	Ekspertë për hartim politikash		
2	Ekspertë për integrimin europian		
3	Ekspertë për implementimin e politikave		
4	Ekspertë për hartimin dhe zbatimin e projekteve		
5	Ekspertë për monitorimin dhe zbatimin e politikave		
6	Ekspertë për vlerësimin e politikave		
7	Ekspertë për kostimin e politikave		
8	Ekspertë për hartimin e standarteve		
9	Tjetër (specifiko)		

2. Mendoni se ekspertët e diasporës shkencore shqiptare do të jenë të vlefshëm për institucionin tuaj?

3. Keni patur ndonjë eksperiencë të mëparshme me ekspertë nga diaspora shkencore shqiptare?

a. Po **b.** Jo **3.** Nuk e di

4. Nqse PO, a mund ta përshkruani me pak fjalë këtë eksperiencë? Ku qëndron ana pozitive e saj?

5. Mendoni se ata do të ishin më të vlefshëm se ekspertët e huaj që vijnë në Shqipëri?

a. Po **b.** Jo **c.** Varet **d.** Nuk e di

Ju lutem shpjegoni vlerësimin tuaj:

6. Sipas jush ku qëndron ndryshimi midis ekspertëve nga diaspora shkencore dhe ekspertëve të huaj?

7. A mund të krijoni kushte pune (zyre, tavoline pune, computer, etj) për ekspertët e diasporës shqiptare që mund të vijnë në institucionin tuaj?

a. Po **b.** Jo **3.** Nuk e di

8. A jeni të gatshëm të shkëmbeni eksperiencë me institucionet ku punojnë ekspertët e diasporës shqiptare?

a. Po

b. Jo

3. Nuk e di

9. Komente të tjera:

Aneksi 2

Questions

1. We would like to know something more about the history of your institution (year of establishment, stages of development, and the perspective).

2. Which is the main field of activity of your institution?

3. What human resources does your institution have? Have they been trained in Albania or abroad? Has your institution suffered from the so-called brain drain? If yes, do you have a databank of these persons?

4. What are the fields in which your institution has the greatest need for specialised expertise? Are you willing to accept Albanian experts from the scientific diaspora to contribute to your institution?

5. In the event some experts from the scientific diaspora come, which is the most appropriate time to come? Are you able to provide adequate conditions and infrastructure for them to be able to give their contribution to your institution?

6. Would you like to establish long-term cooperation relations with these experts and the institutions in which they work?

ENGAGING
DIASPORA
PROFESSIONALS

germin

Tiranë, Tetor 2020